

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBETARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATA E KRYESORIT PRANESHURIS DATE OF DEPUTY CHIEF'S SUBMISSION: 12.09.2023			
Nivini Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Ifaqeve Br. Stranica No. Pages
01	410	1569	5



Zyra Kombëtare e Auditimit
 Nacionalna Kancelarija Revizije
 National Audit Office



Instituti për
 Kontabilitet
 Auditim
 Financa

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

në mes të

ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT

dhe

INSTITUTIT PËR KONTABILITET, AUDITIM DHE
 FINANCA

PRISHTINË
 Shtator 2023



Zyra Kombëtare e Auditimit (në tekstin e mëtutjeshëm referuar si ZKA apo si palë), me adresë në: Prishtinë, Rr. "Ahmet Krasniqi" Nr. 210, përfaqësuar nga **znj. Vlora Spanca – Auditore e Përgjithshme;**

dhe

Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (në tekstin e mëtutjeshëm referuar si IKAF apo si palë), me adresë në: Prishtinë, Rr. "Nazim Gafurri" Nr.15, përfaqësuar nga **Bujar Krasniqi - Drejtor Ekzekutiv;**

Lidhin këtë:

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT

1.1. Me këtë Memorandum, përcaktohet korniza e përgjithshme e bashkëpunimit ndërmjet palëve me qëllim të përkrahjes profesionale në formë të donacionit (pa kompensim të shpenzimeve) për zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të stafit të ZKA-së, në përputhje me standardet ndërkombëtare për institucionet supreme të auditimit (SNISA).

1.2. Përkrahja profesionale realizohet në fushat e përzgjedhura si të:

- ✓ Menaxhimit;
- ✓ Auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit;
- ✓ Auditimit të performancës;
- ✓ Auditimit financiar;
- ✓ Auditimit të pajtueshmërisë;
- ✓ Kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- ✓ Temave të tjera të veçanta në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional;
- ✓ Promovimit të komunikimit të hapur dhe shkëmbimin e informacionit përkatës në lidhje me projektet e bashkëpunimit ndërmjet ZKA-së dhe IKAF-it.

1.3. Palët dakordohen që në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet tyre, mund të mbulohen edhe aktivitete të tjera zhvillimore që synojnë zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale të ZKA-së në përputhje me SNISA-të.

2. FORMA E REALIZIMIT TË PROJEKTEVE

2.1. Korniza e bashkëpunimit në kuadër të përkrahjes profesionale, duke përfshirë zhvillimin e trajnimeve, ligjeratave në tema të caktuara, seminareve në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional etj. propozohet nga IKAF-i. Propozimin për zhvillimin e temave të caktuara mund ta bëjë edhe ZKA.

2.2. Përkrahja profesionale për stafin e ZKA-së ofrohet në vendin e punës, ose në IKAF varësisht nga numri i pjesëmarrësve.

3. OBLIGIMET E PALËVE

1. ZKA merr përsipër obligimet si në vijim:

- 1.1. Paraqitjen e propozimeve për nevojat e përfitimit të projekteve/programeve të caktuara për zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të stafit të ZKA-së;
- 1.2. Përcaktimin e objektivave të nevojshme të stafit për ngritjen e kapaciteteve dhe aftësive profesionale;
- 1.3. Të krijoj mundësi për stafin auditues të ZKA-së dhe stafit tjetër sipas nevojës për vijimin e edukimit të vazhdueshëm profesional;
- 1.4. Propozimin e periudhave kohore për realizimin e projekteve të caktuara;
- 1.5. Të bëjë përgatitjet e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të trajnimeve, duke përfshirë caktimin e zyrtarëve për pjesëmarrje në aktivitetet përkatëse;
- 1.6. Të caktoj një pikë kontaktuese me IKAF-in për koordinimin e të gjitha aktiviteteve.

2. IKAF merr përsipër obligimet si në vijim:

- 2.1. T'i propozoj ZKA-së zhvillimin e projekteve/programeve të caktuara për zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të stafit të ZKA-së;
- 2.2. Të përgatitë projektet e caktuara, të sigurojë burime njerëzore me kompetencë profesionale dhe të zbatoj projektet sipas këtij Memorandumi;
- 2.3. Të koordinojë zbatimin e aktiviteteve për projektet e caktuara në mënyrë që të sigurohet përdorimi sa më i mirë i burimeve dhe për arritjen e rezultateve më të mira të mundshme;
- 2.4. Të ofroj tema relevante sipas kërkesës në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional;
- 2.5. Të asistojë me mbështetje administrative të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të projekteve të përcaktuara;
- 2.6. Të caktoj një pikë kontaktuese për koordinimin e të gjitha aktiviteteve me ZKA-në.

3. Çështjet e veçanta lidhur me Edukimin e Vazhdueshëm Profesional

- 3.1. IKAF merr përsipër zhvillimin e 12 orëve të edukimit të vazhdueshëm profesional për çdo vitë, brenda afatit të kohëzgjatjes së këtij Memorandumi.
- 3.2. Duke pasur parasysh interesin institucional publik, zhvillimi i orëve të caktuara të edukimit të vazhdueshëm profesional sipas paragrafit paraparak bëhet pa kompensim, përkatësisht në formë të donacionit.
- 3.3. Për t'u zbatuar paragrafi 3.1. dhe 3.2. i këtij neni, në trajnimet për edukimin e vazhdueshëm profesional duhet të marrin pjesë punonjësit e ZKA-së të cilët paraprakisht bëhen anëtar në IKAF. Për vijimin e orëve të përcaktuara do të organizohen dy grupe të pjesëmarrësve, përveç nëse palët mirren vesh ndryshe.
- 3.4. Shuma e donacionit për zhvillimin e orëve të caktuara të edukimit të vazhdueshëm profesional sipas paragrafit 3.1. dhe 3.2. të këtij neni mund të deshifrohet në bazë të akteve të IKAF me të cilat përcaktohet tarifa vjetore për anëtarësi dhe për secilën orë të mbajtur për edukimin e vazhdueshëm profesional.

3.5. Krahas orëve të përcaktuara, për vijuesit e atyre orëve IKAF do të njehë edhe orët tjera të edukimit të vazhdueshëm profesional të vijua brenda ZKA-së.

3.6. Vijuesit e trajnimeve sipas këtij Memorandumi nuk janë të kushtëzuar me anëtarësi vjetore në IKAF. Mirëpo, stafit të ZKA-së të cilët në përputhje me "Politikën për edukimin e vazhdueshëm profesional të IKAF-it" e arrijnë normativin vjetor të orëve të edukimit të vazhdueshëm profesional sipas pikës 3.1. dhe 3.5. të këtij neni, mund t'ju njihet drejtpërdrejtë anëtarësia në IKAF në nivelin profesional në të cilin është i certifikuar punonjësi i caktuar. Në bazë të kësaj, këtyre punonjësve iu njihen edhe të drejtat tjera në pajtueshmëri me statusin e anëtarësisë sipas akteve të IKAF-it dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

4. ZBATIMI

4.1. Palët zotohen t'i zbatojnë obligimet e tyre të përcaktuara në këtë Memorandum.

4.2. Palët e përcjellin zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë njëra tjetren për veprimet që duhet të ndërmerren në zbatimin e obligimeve në mbarrëvajtjen e punëve, deri në realizimin e qëllimit të përcaktuar me këtë Memorandum.

4.3 IKAF për çdo vit do të bënë rishikimin dhe vlerësimin e arritshmërisë dhe nivelin e zbatimit të këtij Memorandumi sipas kushteve të përcaktuara.

5. NDËRPRERJA E MEMORANDUMIT DHE RRETHANAT E PAPANISHIKUARA

5.1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve.

5.2. Zbatimi i Memorandumit mund të ndërpritet nëse gjatë rishikimit të zbatimit të detyrimeve, IKAF vlerëson se Memorandumi nuk po zbatohet sipas kushteve të përcaktuara.

5.3. Nëse zbatimi i Memorandumit duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive dhe rrethanave të tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht për ndërprerjen e zbatimit të këtij akti.

6. KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI I MEMORANDUMIT

6.1. Zbatimi i projekteve sipas pikës 1 të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, do të fillojë nga data e nënshkrimit ndërmjet palëve dhe do të zbatohet për një periudhë kohore prej dy (2) vitesh.

6.2. Së paku 30 ditë para përfundimit të afatit për zbatimin e këtij Memorandumi, i njeiti mund të diskutohet ndërmjet palëve dhe të vazhdohet edhe për një periudhë tjetër kohore.

7. AMANDAMENTIMI

7.1. Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshohet apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve.

7.2. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë Memorandum, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në Memorandumin e Bashkëpunimit në të ardhmen, apo në një amendament të këtij Memorandumi, të nënshkruar nga palët, do të konsiderohen si pjesë të integruara në këtë dokument.

8. MOSPAJTIMET

Të gjitha mospajtimet e mundshme ndërmjet palëve për zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet tyre.

9. NËNSHKRIMI DHE HYRJA NË FUQI E MEMORANDUMIT

9.1. Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

9.2. Memorandumi i Bashkëpunimit është përpiluar në dy kopje origjinale, prej të cilave nga një për secilën palë.

Për ZKA-në:

Vlora Spanca

Vlora Spanca
Auditore e Përgjithshme

Për IKAF-in:

Bujar Krasniqi

Bujar Krasniqi
Drejtore Ekzekutive



Prishtinë

Më: 12/09/2023

Prishtinë

Më: 12/09/2023

